



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 24
Prishtinë, më 23 mars 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Synavere Rysha, Hajdar Beqa, Naim Fetahu, Fikrim Damka dhe Abdyl Ymeri.

Munguan: Besnik Bislimi, Bali Muharremaj dhe Enver Hoti.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës, Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ-i.

Pjesëmarrësit e tjerë në takim: Artan Venhari - ZAP, Qendresa Mulaj - ZAP, Fitore Berisha - ZPRK, Florina Merovci - ZPRK, Dren Ajeti - GLPS, Syzana Bytyçi - Jagxhiu, Zyra e BE-së, Blerta Bejtullahu - EUSR/EU Office dhe Agnesa Haxhiu, KDI.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 16.3.2016;**
3. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim amendamenteve për Projektligjin Nr.05/L-055, për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;**
4. **Të ndryshme.**

Zv. kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Zv. Kryetari- konstatoi që aprovet rendi i ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.03.2016

Zv. Kryetari- konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 16.03.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim amendamenteve për Projektligjin Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës;

Ali Sadriu, zëvendëskryetar, njoftoi se administrata e komisionit ka përgatitur amendamentet të cilat kanë dalë nga punësoria e mbajtur javën e kaluar dhe në lexim e sipër, u votua për secilin amendament veç e veç.

Amendamenti 1

Neni 3, paragrafi 1, pika 1.2. Në pjesën e parë të paragrafit, pas fjalës “mendimit” të shtohet “ në formë të shkruar për pasqyrat financiare, ose ndonjë proces të caktuar” ndërsa pjesa tjetër të mbetet si në projektligj.

Amendamenti u aprovua njëzëri.

Amendamenti 2

Neni 4 paragrafi 2, pas fjalës “në këtë ligj” , shtohet edhe fjala “në aktet nënligjore” , ndërsa pjesa tjetër mbetet si në projektligj.

Amendamenti u aprovua njëzëri.

Amendamenti 3

Neni 4 paragrafi 5, të fshihet.

Amendamenti u aprovua njëzëri.

Amendamenti 4

Neni 4, paragrafi 6, të shtohet pika 6.3” Nuk është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 3 vjeçare, para datës së aplikimit ka qenë zyrtar i zgjedhur publik, i emëruar politikisht ose bartës i një posti udhëheqës, ose vendimmarrës në një subjekt politik”.

Amendamenti u aprovua njëzëri.

Amendamenti 5

Neni 4, paragrafi 11 pika 11.2, shprehja “të pahijshme dhe të pasjellshme” zëvendësohet me shprehjen “që bie ndesh me kodin etik”. Amendamenti u aprovua njëzëri.

Amendamenti 6

Neni 4, paragrafi 11, pas pikës 11.2, të shtohen dy pika të reja me këtë përmbajtje:

11.3. Nëse ndaj Auditorit të Përgjithshëm ngritët aktakuzë për vepër penale, ai/ajo suspendohet me pagesë prej pesëdhjetë për qind (50%) të pagës së tij/ saj, deri në largimin e tij/ saj ose derisa të shpallet i pafajshëm me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës. Suspendimi hyn në fuqi që nga momenti i ngritjes së aktakuzës nga ana e prokurorit.

11.4. Gjykata kompetente në ditën e ngritjes së aktakuzës ndaj Auditorit të Përgjithshëm e dërgon njoftimin tek Kryetari i Kuvendit, i cili në emër të Kuvendit, si institucion i cili e ka emëruar, e njofton Auditorin e Përgjithshëm për suspendimin e tij. Këtu **Zv. kryetari i Komisionit** theksoi se duhet të shtohet fjalia në këtë amendament se Kryetari i Kuvendit e njofton Auditorin, pasi paraprakisht ta njoftojë Kuvendin.

Artan Venhari, tha se është mirë që pika 11.3 dhe 11.4, të mbetet si paragraf 12, e jo kështu siç janë të paraqitura në amendamentin 6. Pra pika 11.3 dhe 11.4, bëhen 12.1 dhe 12.2 të paragrafit 12 amendamenti 6.

Amendamenti u aprovua njëzëri, me propozimet e fundit.

Amendamenti 7

Neni 12, në vend të fjalës “**punonjës**”, bëhet fjala “**vartësit**”.

Amendamenti u aprovua njëzëri.

Amendamenti 8

Neni 16 paragrafit 1, në fund ti shtohet fjalia “**ndërsa stafi tjetër trajtohet në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil**”.

Amendamenti u aprovua njëzëri..

Amendamenti 9

Neni 16 paragrafi 2, fshihet, ndërsa **zv. kryetari i Komisionit** propozoi se këtu është mirë të shtohet edhe **Ligji i Punës** e jo të fshihet paragrafi 2.

Synavere Rysha, theksoi se është mirë të përmenden të dyja ligjet; ai i punës si dhe ai i shërbimit civil, për arsye se në ZAP do të jenë tani dy lloje të të punësuarve.

Amendamenti u aprovua njëzëri, me ndryshimet e fundit.

Amendamenti 10

Neni 19 paragrafi 5, pika 5.4, të fshihet.

Amendamenti 10 u aprovua njëzëri.

Amendamenti 11

Neni 21 paragrafi 2, pas fjalisë “ e dorëzon tek KMFP-ja”, të shtohet “deri më 31 tetor të vitit paraprak”.

Amendamenti u aprovua njëzëri.

Amendamenti 12

Neni 19 paragrafi 3, pas pikës 3.2, të shtohet një pikë e re 3.3 me këtë përmbajtje: “**pasqyrat financiare të subjekteve politike, të cilat u ndahen nga buxheti i Kosovës**”. Zv. kryetari i Komisionit, Ali Sadriu, theksoi se është mirë të fshihet pjesa pas presjes „**të cilat u ndahen nga buxheti i Kosovës**”.

Artan Venhari, theksoi se kjo përgjegjësi nuk mund ti bartet ZAP-it, sepse kjo është e rregulluar me Ligjin për Financim të Subjekteve Politike.

Naim Fetahu, shtoi se kjo përgjegjësi duhet të jetë e ZAP-it.

Abdyl Ymeri, theksoi se përveç grandeve të dhëna nga Qeveria për Subjektet Politike, është mirë që të bëhet auditimi edhe i donacioneve që kanë subjektet politike.

Hajdar Beqa-, shtoi se nëse ky nen mbetet kështu siç është propozuar, atëherë duhet të ndryshohet Ligji për Financim të Subjekteve Politike.

Dren Ajeti, theksoi se meqenëse auditimi i subjekteve politike nuk po ec mirë, ashtu siç është dhënë me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike, atëherë, ne përkrahim këtë propozim që është dhënë në amendamentin 12 të KMFP-së.

Amendamenti 12 u aprovua njëzëri, me ndryshime, ku fshihet pjesa „**të cilat u ndahen nga buxheti i Kosovës**”.

Amendamenti 13

Neni 25, shprehja “**kur vëren tregues të shkeljeve të mëdha**”, zëvendësohet me shprehjen “**kur vëren se ka shkelje ligjore**” dhe shprehja “**hetimet e krimit**” bëhet “**hetimet**”.

Amendamenti u aprovua njëzëri.

Amendamenti 14

Neni 26 paragrafit 2, në fund të fjalisë të shtohet “**nga ai ose ajo**”.

Amendamenti 14 u aprovua njëzëri.

Amendamenti 15

Neni 29, fjala “**të zyrtarëve**”, të bëhet “**të auditorëve**”.

Amendamenti u aprovua njëzëri.

Amendamenti 16

Neni 30 paragrafi 4, fjala “ **në zbatim**”, të bëhet “ **në fuqi**”.

Amendamenti u aprovua njëzëri.

Amendamenti 17

Të harmonizohet dhe korrigjohet gjuhësisht dhe teknikisht i gjithë teksti i projektligjit

Amendamenti u aprovua njëzëri.

Amendamenti 18

Zv.kryetari i Komisionit, theksoi se kemi pas një diskutim, që edhe zv. auditori të zgjidhet nga deputetët në seancë plenare. Me këtë hapi diskutimin për këtë amendament.

Hajdar Beqa, theksoi se zv. auditori duhet të zgjidhet nga vetë auditori e jo në seancë plenare.

Synavere Rysha, tha se në çfarëdo mënyre që të vendosim për zgjedhjen e zv.auditorit, ne duhet të kemi parasysh që të mos e cenojmë pavarësinë e Zyrës së Auditorit.

Naim Fetahu, theksoi se zv. auditori duhet të zgjidhet në seancë plenare.

Zv. kryetari i Komisionit, Ali Sadriu, theksoi se do të presim nëse komisionet e përhershme të Kuvendit e veçanërisht Komisioni për Legjislacion, mos ka ndonjë propozim, nëse zv. auditori mbetet të zgjidhet nga Kuvendi apo jo dhe pastaj do të vendosim prapë.

Përfundim

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike, vendosi njëzëri që amendamentet e aprovuara, të adresohen për në komisionet e përhershme të Kuvendit.

4. Të ndryshme.

Pasi nuk pati të interesuar për të diskutuar në këtë pikë, zv. kryetari i komisionit e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zv. kryetari i Komisionit

Ali Sadriu